

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 26 mars 2025

Z. Përparim Rama, Kryetar
Komuna e Prishtinës
Rr. "UÇK", nr. 2
10 000 Prishtinë

LETËR REKOMANDIMI

R.nr. 1052/2024

lidhur me cenimin e së drejtës për shkollim të fëmijës, mosofrim i transportit për distancën më të gjatë se 4 kilometra

I nderuari z. Rama,

Avokati i Popullit (IAP), në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 17 tetor 2024 pranoi ankesën e z. Mirsad Aliut (në tekstin e mëtejshme: ankuesi), parashtruar kundër Komunës së Prishtinës – Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA), përkitazi me mospërgjigje në kërkesën e parashtruar për sigurimin e transportit për fëmijën e tij - nxënës që vijon mësim mbi katër kilometra larg shtëpisë.

Sipas pohimeve të ankuesit, më 23 shtator 2024, në e-mailin zyrtar të drejtorit të DKA-së në Prishtinë parashtroi ankesë lidhur me mossigurimin e transportit për vijim të mësimit në klasën e parë për fëmijën e tij, i cili mësimin duhet ta ndjekë në distancën prej më shumë se 4 kilometrash vetëm në një drejtim. Ankuesi pohoi se nuk ndërmori ndonjë veprim procedural, madje as nuk pranoi përgjigje në ankesën e tij.

Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të ankesës, ndërmori veprimet si në vijim:

Avokati i Popullit më 21 nëntor 2024 iu drejtua kryetarit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë për informata lidhur me veprimet që planifikoheshin të ndërmerren nga DKA-ja, mirëpo nuk mori përgjigje.

Avokati i Popullit më 27 janar 2025 përsëri kërkoi nga kryetari i Komunës së Prishtinës informata në lidhje me këtë, por nuk mori përgjigje.

Përfaqësuesja e Avokatit të Popullit bisedoi me ankuesin, nga i cili u njoftua se fëmija i tij ndjek procesin mësimor në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "7 Marsi" në lagjen Emshir - Prishtinë, e cila nga vendbanimi i tyre ka distancë prej 5.7 kilometrash.

Dispozitat përkatëse ligjore lidhur me çështjen

Kushtetuta e Republikës së Kosovës¹, në nenin 21, paragrafi 1, përcakton: "*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë*

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.” Kurse paragrafi 2 i këtij neni thotë: “Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”

Kushtetuta, në nenin 22 (Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), përcakton: “Të drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: [...] 7. Konventa për të Drejtat e Fëmijës. [...]”

Kushtetuta, në nenin 47 [E Drejta për Arsimin], përcakton: “1. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike. 2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.”

Ndërsa Kushtetuta në nenin 50 (Të Drejtat e Fëmijës), përcakton: “Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.”

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF), në neni 3, pos të tjerash, përcakton se në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë mbizotëruese.

KDF-ja, në nenin 28, përcakton: “Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta në mënyrë të veçantë ata:

U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme [...].”

KDF-ja, në nenin 28, përcakton detyrimin për shtetet palë që të angazhohen, pos të tjerash, që ta bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë, me qëllim që të arrihen synimet e arsimit të fëmijëve, në pajtim me nenin 29 të Konventës.

Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 17 / 16 shtator 2011, Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Ligji për Arsimin)², në nenin 3, paragrafi 3, përcakton: “Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t’u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.”

Ligji për Arsimin, në neni 15, paragrafi 5, përcakton: “Për të promovuar vijimin ose zvogëluar braktisjen e shkollës, komuna organizon transport të sigurtë dhe efikas për nxënësit në shkollimin e detyruar. Komuna mund të kërkoj pagesë por edhe mund ta bëjë falas transportin shkollor. 5.1 “nxënësit që jetojnë në zonën e mbulimit, por që janë brenda distancës prej katër (4) kilometra nga shkolla, [...]”

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

Nga ato që u theksuan më lart, Avokati i Popullit konstaton se Komuna e Prishtinës ka dështuar t'i përmbushte obligimet e saj ligjore në lidhje me sigurimin e transportit për fëmijën e ankuesit, i cili ndjek mësimin në një distancë prej më shumë se 4 kilometrash nga vendbanimi i tij. Ky dështim në veçanti përbën shkelje të Nenit 15, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, i cili përcakton se institucionet arsimore dhe autoritetet komunale janë të obliguara të sigurojnë qasje të barabartë në arsim për të gjithë nxënësit, përfshirë sigurimin e transportit për ata që banojnë larg shkollës.

Avokati i Popullit vlerëson se mosrealizimi i këtij shërbimi nga ana e Komunës përbën shkelje të së drejtës për arsim dhe barazi në qasje. Si rezultat, në këtë letër i rekomandohet Komunës së Prishtinës që të ndërmarrë masa urgjente për ta siguruar transportin e nevojshëm për fëmijën në fjalë, në mënyrë që të mos pengohet e drejta e tij për arsimim.

Për më tepër, Avokati i Popullit i kërkon Komunës së Prishtinës që t'i rishikojë politikën dhe praktikën e saj në raport me transportin e nxënësve që jetojnë në distanca të largëta, në mënyrë që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen dhe të sigurohet respektimi i plotë i të drejtave të nxënësve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *"Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore"*; dhe sipas nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, duhet: *"Të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritete i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla."*


Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Komunës së Prishtinës - Drejtorisë Komunale të Arsimit:

T'i ndërmarrë masat përkatëse për ofrimin e transportit për fëmijën i cili ndjek mësimin në distancën prej më gjatë se 4 kilometrash nga vendbanimi deri në shkollën "7 Marsi".

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*"Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj."*) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (*"Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë."*), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit